

VENDIM
Nr. 418, datë 10.5.2017

**PËR STANDARDDET, KRITERET DHE
PROCEDURAT PËR HAPJEN,
RIORGANIZIMIN, NDARJEN,
BASHKIMIN OSE MBYLLJEN E
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË DHE TË DEGËVETË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29, 30 e 31, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjekte juridike, vendase ose të huaja, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, depozitojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin për hapjen e një institucionit të arsimit të lartë ose degë të një institucionit ekzistues. Afati fundor i depozitimit është data 15 maj, për vitin e dytë pasardhës akademik.

2. Subjekti kërkues për hapjen e një institucionit të arsimit të lartë duhet të përbushë standarde e mëposhtme:

a) Standardet e organizimit të IAL-së:

i) Organi më i lartë akademik i IAL-së është Senati Akademik.

ii) Organi më i lartë administrativ i IAL-së është Bordi i Administrimit.

iii) Autoriteti më i lartë akademik i IAL-së është Rektori. Rektori është personel akademik me kohë të plotë.

iv) Autoriteti më i lartë administrativ i IAL-së është administratori i saj.

v) Autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore është Dekani. Dekani është personel akademik me kohë të plotë.

vi) Autoriteti më i lartë administrativ i njësisë kryesore është administratori i saj.

vii) Autoriteti më i lartë akademik i njësisë bazë është drejtues i saj. Drejtuesi i njësisë bazë është personel akademik me kohë të plotë.

viii) Autoriteti më i lartë administrativ i njësisë bazë është administratori i saj. Ai është personel administrativ me kohë të plotë.

ix) Asambleja e personelit akademik është organi i IAL-së, që zgjedh rektorin, dekanin dhe organet akademike të IAL-së.

x) Një institucion i arsimit të lartë organizohet në njësi përbërëse kryesore dhe bazë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë, duke respektuar llojin e institucionit.

xi) Çdo njësi kryesore duhet të ketë, të paktën, tre

njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përaferta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive.

xii) Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të janë me gradë shkencore ose titull akademik.

xiii) Një institucion i huaj i arsimit të lartë apo degë e tij, që zoteron një formë akreditimi në një shtet tjeter, mund të ketë organizim tjeter strukturor, në varësi të formës në shtetin e origjinës.

b) Standardet për personelin akademik të IAL-së:

i) Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, është sipas shkronjës "A", të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

ii) Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.

c) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së:

i) Standarde ndërtimore të IAL-ve të janë në përputhje me kuadrin ligor në fuqi për institucionet arsimore dhe ato të janë të vendosura larg varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara, sipas standardeve përkatëse.

ii) Objektet që do të përdoren për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë duhet të përbajnjë, minimalisht, ambientet sipas shkronjës "B", të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, dhe natyrës së programeve të studimit që do të ofrojnë.

iii) Objektet që do të ofrohen për institucionet e arsimit të lartë, duhet të plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, të ndara sipas fushave të studimit, sipas shkronjës "C", të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

iv) Numri i studentëve, sipas veprimtarive akademike, nuk duhet të jetë më i madh se numri i përcaktuar në shkronjës "D", të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

ç) Objektet e arsimit të lartë, me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të janë të pajisur me dalje dhe shkallë emergjence.

d) Të gjitha objektet, që do të shërbejnë si institucione të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit ose të janë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

dh) Institucionet e arsimit të lartë duhet të janë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë/mjedisë shëndetësor dhe mjetet e pajisjet e nevojshme për ketë qëllim.

e) Objektet e arsimit të lartë duhet të kenë të garantuar burime alternative për furnizimin me

energji elektrike si edhe rezerva të mjaftueshme të ujut të përdorshëm.

ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohje.

3. Për hapjen e një institucionit të arsimit të lartë të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni për hapjen e institucionit të arsimit të lartë depozitohen në ministrinë përgjegjëse të arsimit të lartë.

b) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë verifikon plotësimin e standardeve dhe të kritereve për hapjen e IAL-së. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, për vlerësimin e plotësimit të tyre, cakton ekspertë të jashtëm nga lista e ASCAL-it. Shpenzimet e ekspertit paguhën nga kërkuesi.

c) Eksperti/ASCAL-i, brenda 3 javëve, dorëzon raportin e vlerësimit në MAS. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij, brenda tre javëve nga marrja e rapportit të vlerësimit. Nëse edhe pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin përfundimtarin e kërkuesit.

ç) Në rastin e refuzimit të një projekti të paraqitur, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë informon aplikantin për vendimin dhe shkaqet e marrjes së tij, brenda një afati 30-ditor nga data e aplikimit.

d) Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë i propozon Këshillit të Ministrave hapjen e institucionit të arsimit të lartë.

dh) Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë nxjerr urdhrrin për fillimin e veprimitarës së institucionit.

e) Kur subjekti juridik kërkon të transferojet aktin e hapjes së IAL-s një subjekti tjeter juridik, ai duhet të marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Subjekti juridik që ka marr të drejtën, duhet të përmblushë të gjitha kushtet dhe standardet e përcaktuara, të cilat verifikohen në vijimësi nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

4. Për riorganizimin e një institucionit të arsimit të lartë të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë. Iniciativa për riorganizimin e IAL-së/IAL-ve merret nga IAL-të e interesuara, me vendim të organeve kolegiale të saj.

b) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, për vlerësimin e dokumentacionit, cakton ekspertë të jashtëm nga lista e ASCAL-it. Shpenzimet e ekspertit paguhën nga kërkuesi.

c) Eksperti/ASCAL-i, brenda 3 javëve, dorëzon raportin e vlerësimit në MAS. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin përfundimtarin e tij, brenda 2 javëve nga marrja e rapportit të vlerësimit.

ç) Në rast se tre javë pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, kërkesa refuzohet dhe dosja e aplikimit arkivohet. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njofton me shkrim institucionin kërkues përfundimtarin e tij, të argumentuar, dhe praktika arkivohet.

d) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rast të vlerësimit pozitiv, nxjerr aktin e riorganizimit të institucionit të arsimit të lartë, jo më vonë se 3 muaj pas dorëzimit të dokumentacionit.

5. Për ndarjen ose bashkimin e një institucionit të arsimit të lartë, të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni për bashkimin e dy ose më shumë IAL-ve ekzistuese për krijimin e një IAL-je të vetme apo ndarjen e IAL-së në dy ose më shumë IAL, nga një IAL e vetme ekzistuese, merret nga vetë institucionit/ institucionet e interesuara. Procesi i bashkimit ose ndarjes nuk duhet të cenojë standartet e sigurimit të cilësisë.

b) Në rastet e shkrirjes së IAL-ve, përgjegjësitë dhe asetat e IAL-ve të mëparshme i transferohen IAL-së së re, ndërsa, në rastet e përfshirjes së IAL-ve në procesin e bashkimit, ngelet një IAL e vetme, e cila administron përgjegjësitë dhe asetat edhe të IAL-së/IAL-ve të përfshira.

c) IAL-të e përfshira në procesin e bashkimit ose të ndarjes janë përgjegjëse për realizimin e procesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar një vijimësi normale të procesit akademik si dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve të përfshira në këtë proces.

ç) Autoritetet drejtuese të IAL-së/IAL-ve pjesëmarrëse në këtë proces janë përgjegjëse për realizimin e tij. Menaxhimi financiar dhe administrativ në procesin e bashkimit ose të ndarjes, gjatë periudhës tranzitore, bëhet në përputhje me statutin e IAL-ve dhe legjislacionin në fuqi.

d) Kërkesa dhe dokumentacioni për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

dh) Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton IAL-në/IAL-të përfundimtarin e tij. Nëse brenda tre javëve, nga marrja e njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin aplikues përfundimtarin e kërkuesit.

e) Në rastin e refuzimit të kërkuesit së paraqitur,

ministria përgjegjëse për arsimin e lartë informon aplikantin për vendimin dhe për shkaqet e marrjes së tij brenda një afati 90-ditor, nga data e aplikimit. Praktika arkivohet në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

ë) Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtarë është pozitiv, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë i propozon Këshillit të Ministrave ndarjen/bashkimin e institucionit/institucioneve të arsimit të lartë.

6. Për mbylljen e institucionit/eve të arsimit të lartë ose të degëve të tyre të respektohet procedura dhe kriteret e mëposhtme:

a) Mbyllja e IAL-së bëhet, në çdo rast, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës të arsimit të lartë, ndërsa mbyllja e degëve të IAL-ve bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave dhe urdhri përkatës i ministrit përgjegjës për arsimin e lartë përcaktojnë pasojat dhe detyrimet që lindin, përkatësisht, nga mbyllja e IAL-së/ve ose degëve të tyre.

b) Në rastet e mbylljes së IAL-së vullnetarisht, nga vetë institucioni, nevojitet propozimi i senatit akademik dhe miratimi i bordit të administritimit.

c) Në rastet e mbylljes së IAL-së me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin e lartë, nevojitet, paraprakisht, mendimi i senatit akademik dhe i bordit të administritimit, të cilët shprehen brenda një muaji, nga data e propozimit të dërguar nga ministri.

ç) Një institucion i arsimit të lartë mbylliет detyrimisht, si pasojë e:

i) shkeljeve të konstatuara nga kontrolli i ligjshmërisë;

ii) shkeljeve të konstatuara nga auditimi i IAL-së;

iii) vlerësimi negativ nga procesit i akreditimit institucional.

d) Ministri përgjegjës për arsimin e lartë, në rast konstatimesh të shkeljeve të ligjshmërisë, mund të vendosë edhe kushte, si masë paraprake, mosplotësimi i të cilave brenda afateve të përcaktuara çon në mbylljen e IAL-së.

dh) Ministri përgjegjës për arsimin e lartë, në rast konstatimesh të shkeljeve të ligjshmërisë, vijimësia e të cilave sjellë dëme të rënda dhe të pariparueshme për interesin publik, vendos për pezullimin e veprimtarisë së IAL-së, si masë e ndërmjetme deri në vendimmarrje përfundimtare. Pezullimi mund të jetë i pjesshëm ose i plotë, me afat deri në dy vjet.

e) Mbyllja e IAL-së bëhet kur IAL-ja nuk përbush kriteret thelbësore të hapjes, shkel rëndë detyrimet e përcaktuara në të, për përfitime abuzive që rëndojnë mbi interesat ekonomike të studentëve, si dhe kur marrja e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë është realizuar nëpërmjet mashtrimit, falsifikimit të dokumenteve, pasqyrimit të të dhënave të pavërteta dhe çdo shkeljeje tjetër të

procedurës administrative. Konstatimi i mosplotësimit të kritereve apo shkeljes së detyrimeve bëhet si rregull nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

7. Për hapjen e degëve të institucioneve të arsimit të lartë të respektohet procedura dhe kriteret e mëposhtme:

a) Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore dhe kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtë, brenda kompetencave dhe fushave të veprimtarive të tyre akademike, të hapin degë të tyre jashtë selisë qendrore, për të ofruar programe të studimeve, kërkim shkencor, veprimtari trajnuese, shërbime dhe veprimtari të tjera.

b) Këtë të drejtë e kanë edhe institucione të arsimit të lartë me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë. Këto institucione duhet të janë të akredituara në vendin e tyre të origjinës. Dega e institucionit të arsimit të lartë, që e ka selinë qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, organizohet dhe administrohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

c) Dega e institucionit të arsimit të lartë, vendas ose e huaj, është:

i) pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore të institucionit;

ii) njësi e veçantë në strukturën e institucionit të arsimit të lartë, si njësi kryesore ose njësi bazë.

ç) Degët e IAL-ve, që kanë seli qendrore dhe kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, duhet të:

i) përbushin standarde akademike për personelin akademik;

ii) përbushin standarde infrastrukturore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimëve të këtij vendimi;

iii) paraqesin plan-biznesin,

iv) marrin përsipër mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë së tyre akademike, për një periudhë, të paktën 3-vjeçare.

v) vetëdeklarojnë, në çdo rast, burimin e financimit.

d) Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj dhe që duan të hapin degë të tyre në Republikën e Shqipërisë, paraqesin pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë dosjen e aplikimit jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti.

dh) Në rastet e hapjes së degës në nivel njësie bazë, në Republikën e Shqipërisë, institacioni i arsimit të lartë duhet të depozitojë në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë dosjen e aplikimit, jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti.

e) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rast të vlerësimit pozitiv të dosjes, nxjerr aktin e hapjes së degës në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie

bazë për institucionet e arsimit të lartë, me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 3 muaj pas dorëzimit të dosjes.

ë) Në rastet e hapjes së degës në nivel njësie bazë, për institucionet e arsimit të lartë brenda Republikës së Shqipërisë, pas vendimit të senatit akademik dhe miratimit të bordit të administrimit, njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë brenda 30 ditëve.

f) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njofton me shkrim institucionin kërkues dhe praktika arkivohet.

8. Projektet e paraqitura për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin apo mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë ose të degëve të tyre

përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, trajtohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në kohën e paraqitjes së projektit.

9. Projekti për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë ose degë të një institucioni ekzistues, përjashtimisht për vitin 2017, mund të paraqiten deri më 30 qershor, për vitin e dytë pasardhës akademik.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

ANEKSI 1

A. Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë / student, sipas fushave kryesore të studimit, është si më poshtë:

Fusha	Personeli akademik	Studentë
Shkencat natyrore	1	45
Inxhinieri dhe teknologji	1	35
Shkenca mjekësore dhe shëndetit	1	35
Shkenca bujqësore dhe veterinarisë	1	45
Shkenca sociale	1	45
Shkenca humane dhe arte	1	45

B. Ambientet minimale të nevojshme për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë, sipas natyrës së programeve të studimit që do të ofrohen, janë si më poshtë:

1. Auditorë mësimi;
2. Ambiente për laboratorë dhe ndjekje praktikash klinike mjekësore;
3. Ambiente për personelin akademik;
4. Ambiente për personelin administrativ;
5. Ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, kompjuterësh etj;
6. Ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit te godinës si kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike, etj) oborr dhe ambiente të gjelbëruara.

C. Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndara sipas fushave të studimit, për objektet që do të ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë, është si më poshtë:

Fusha	Sipërfaqja në m ² për studentë
Shkencat natyrore	2.5 m ²
Inxhinieri dhe teknologji	5 m ²
Shkenca mjekësore dhe shëndeti	5 m ² /
Shkenca bujqësore dhe veterinarisë	2.5 m ²
Shkenca sociale	2.5 m ²
Shkenca humane dhe arte	2.5 m ²

D. Numri i studentëve sipas veprimtarive akademike, nuk duhet të jetë më i madh se:

Fusha e studimit	Nr.Studentëve/ Seminar	Nr.Studentëve/ Laborator	Nr.Studentëve/ Praktika	Nr.Studentëve/ leksion
Shkenca Natyrore	35	25	25	6 grupe seminari
Inxhinieri & Teknologji	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca Mjekësore dhe Shëndetit	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca Agrikulturore dhe Veterinarisë	35	25	25	6 grupe seminari
Shkenca Sociale	35	25	25	6 grupe seminari
Humanitete dhe Arte	35	25	25	grupe seminari

